P.nr.43/2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me procesmbajtësin Shani Canziba, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. I. nga fshati X., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 7 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1391/2013 të datës 24.01.2014, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datën 26.10.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Bajram Kryeziu, dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari,

I. I., nga i ati Sh. dhe e ëma N., e lindur K., i lindur me datë ..., në fshatin X., Komuna e Rahovecit, ku edhe tani banon, me nr. personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e fillore, punëtor fizik, i martuar**,** i ati i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar.

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me dt.05.08.2013, rreth orës 12:30 minuta, duke qarkulluar në rrugën Xërxë-Gexhe pikërisht në "Kodrën e Gradishit", e duke drejtuar automjetin e tipit "Opell-Vectra", me regj. ...-...-..., i akuzuari I. I. në kundërshtim me rregullat nga neni 34.1 mbi LSBKRR-ës, nga pakujdesia për shkak të vozitjes së pakujdesshme dhe mos mbajtjes së distancës me automjet e godet në mënyrë zingjirore 6 veturat si:veturën "VW-Golf-3 Karavan", ngjyrë të bardhë, me regj....-...-CM, me ngasës B. Z. I., e cila ishte ndalur në rrugë e me pas ky automjet ka goditur veturën tjetër para tij "VW Passat", ngjyrë hiri, me regj....-...-DF, me ngasës E. Z. I. i cili po ashtu ishte i ndalur e me pas vetur "VW", ka goditur veturën "Opel Vectura", me regj.slloven ...-..., me ngasës N. M. S., i cili po ashtu ishte i ndalur, e më pas vetura Opel Vectra, e ka goditur veturën "VW Golf-4", ngjryrë hiri, me regj....-...-BF, me ngasës D. H. V., i cili ishte i ndalur, e në momentin e goditjes nga vetura Golf-4, është goditur vetura "Opel Vectra", ngjyrë hiri, me regj.Gjerman ...-GB-..., me ngasës G. G. e cila ishte e ndalur, me çka është shkaktuar aksidenti zingjiror me dëme materiale të konsideruara në gjashtë (6) veturat e përfshira në aksident si dhe lëndime të lehta trupore ka pësuar B. Z. I. nga fshati X., Komuna e Rahovecit.

Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 7 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

Konform nenit 77 lidhur me nenin 78 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së,

I akuzuari I. I. **LIROHET NGA DËNIMI**, pasi që pasojat e veprës penale të kryer e kanë goditur kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: Në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 40.88 euro, në emër të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit rrugor shumën prej 40.88 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit: 1.B. Z. I. nga Gjakova, rr. "Y. M." p.nr.
2.E. Z. I. nga Gjakova, rr. "H. A." p.nr.
3.N. M. S., fshati P. i U., Komuna e Rahovecit,
4.D. (H.) V. nga fshati Z., Komuna e Rahovecit,
5.G. (K.) G., fshati S., Komuna e Rahovecit, udhëzohen që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP.nr.1391/2013 të datës 24.01.2014, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin I. I. nga fshati X., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 7/1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të provave i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata, me datë 26.10.2018, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku të pranishëm kanë qenë Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu dhe i akuzuari I. I., me ç'rast prokurori i shtetit edhe pas leximit dhe analizimit të aktakuzës ka qëndruar në tërësi pranë saj.

I akuzuari I. I., ka deklaruar se: E pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e fajëson prokuroria, e ndien veten fajtor dhe pendohet për rastin që ka ndodhur, por e ka informuar gjykatën se në këtë aksident trafiku ka pësuar edhe vetë lëndime trupore, si dhe dëme të konsiderueshme materiale, e poashtu lëndime trupore ka pësuar edhe familjari i tij. Pas shkaktimit të aksidentit i ka ofruar ndihmë të dëmtuarve, me ç'rast i ka vizituar edhe në shtëpi dhe ju ka kërkuar falje. Ka premtuar para gjykatës së në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë vozitjes si dhe nuk do të kryen vepër tjetër penale. Andaj duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, si dhe faktin se në këtë aksident trafiku lëndime trupore ka pësuar familjari i tij, e ka lutur gjykatën që me rastin caktimit të dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjykata, gjithashtu e ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Bajram Kryeziu, ka deklaruar se: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që pranimi ka mbështetje edhe në provat materiale si në ekspertizën e trafikut dhe ekspertizën e mjekut ligjor lidhur me natyrën e lëndimeve trupore për të dëmtuarit, si dhe në shkresat tjera të lëndës.

Andaj ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, por me rastin e matjes së dënimit ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese, si pranimin e fajësisë, kërkim falje, pendimin si dhe premtimin e të akuzuarit se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, e meqenëse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 246 dhe 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe nuk është lëshuar në procedurën e provave, e as në fjalën përfundimtare, por ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas shqyrtimit të kësaj çështje penale në shqyrtimin fillestar ka gjetur se i akuzuari ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 7 lidhur me par 6 dhe 1 të KPRK-së, dhe gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte e përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- deklarata e të akuzuarit dhe të dëmtuarit e dhënë në Polici dhe Prokurori,
- ekspertiza PP.nr.1391/13 dt.02.09.2013 nga ing.dip.kom. L. S.,
- raporti mjeko-ligjor PP.nr.1391/13 të dt.17.12.2013 në emër të dëmtuarit B. Z. I. dhe I. I. si dhe
- raporti mbi shikimin e vendit të ngjarjes, skica, foto dokumentacioni, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Andaj, në bazë të këtyre provave dhe vet pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, e meqenëse është konstatuar se i akuzuari I. I., faktin se veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, i njëjti edhe vet ka pësuar dëme materiale, lëndime trupore ka pësuar familjari i tij, si dhe pasojat e veprës penale të kryer e kanë goditur kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij, gjykata ka ardhur në përfundim që i njëjti është fajtor, por për shkak të rrethanave të përshkruara më lart, të akuzuarin e ka liruar nga dënimi, në kuptim të nenit 77 dhe 78 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2, nënpar.2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil, sipas nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 365 të KPPK-së, lidhur me nenin 77 dhe 78 par.1 nënparagrafi 1.1 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
- Divizioni Penal -
P.nr.43/2014 me datë 26.10.2018

Sekr. juridik,
Shani Canziba

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ilir Rashkaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.